



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:065461
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05611802

C.nr.300/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Fuad Haliti, në çështjen juridike kontestimore të paditësve 1.A.... K.... R..., 2.A.... S....., 3.Sh.... Sh....., 4.P... S.... dhe 5.G.... I..., nga Mitrovica, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av.Leutrim Ademi, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës, me objekt kontesti, kompensimi i shujtave ushqimore, jashtë seancës gjyqësore konform nenit 398 dhe 399 të LPK-së, me datën 24.04.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M
(për shkak të mosbindjes)

- I. APROVOHET në tërësi** kërkesëpadia e paditësve 1.A... K... R..., 2.A... S....., 3.Sh.... Sh....., 4.P.... S.... dhe 5.G.... I..., nga Mitrovica.
- II. OBLIGOHET** e paditura Komuna e Mitrovicës që paditëses **1.A.... K... R....** t'ia paguaj në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës(shujtat ditore), për 391 ditë pune për periudhën nga data 21.01.2021 deri me 22.11.2022, shumën në lartësi prej 782€, paditëses **2.A.... S....** t'ia paguaj në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës(shujtat ditore), për 391 ditë pune për periudhën nga data 21.01.2021 deri me 22.11.2022, shumën në lartësi prej 782€, paditëses **3.Sh.... Sh....** t'ia paguaj në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës(shujtat ditore), për 391 ditë pune për periudhën nga data 21.01.2021 deri me 22.11.2022, shumën në lartësi prej 782€, paditësit **4.P.... S....** t'ia paguaj në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës(shujtat ditore), për 391 ditë pune për periudhën nga data 21.01.2021 deri me 22.11.2022, shumën në lartësi prej 782€, paditësit **5.G.... I....** t'ia paguaj në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës(shujtat ditore), për 391 ditë pune për periudhën nga data 21.01.2021 deri me 22.11.2022, shumën në lartësi prej 782€, të gjithëve me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e parashtrimit të paditësë (dt.22.02.2023) e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- III.OBLIGOHET** e paditura Komuna e Mitrovicës, që paditësve t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 333.00€, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Arsyetim

1. Pretendimet e palëve

Paditësit, me datën 22.02.2023, pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës, të cilën e kanë precizuar me parashtrësën e datës 08.11.2023, me anë të së cilës kanë kërkuar që të obligohet e paditura t'ia paguaj në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës (shujtat ditore), për 391 ditë pune për periudhën nga data 21.01.2021 deri me 22.11.2022, nga 782€ secilit.

E paditura, me datën 24.04.2024, ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, mirëpo nuk ka paraqitur përgjigje në padi.

2. Provat e administruara

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: vërtetimet me nr.529, 528, 525, 526 dhe 534 të gjithë të datës 13.10.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit jashtë seance ashtu që me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditësve është **e bazuar**.

3. Faktet

Me leximin e vërtetimeve me nr.529, 528, 525, 526 dhe 534 të gjithë të datës 13.10.2023, gjykata vërtetojë faktin se paditësit janë të punësuar tek e paditura në Shkollën e Mesme të Lartë të Mjekësisë “Dr.Xheladin Deda” dhe nga data 21.01.2021 deri me datën 22.11.2022, kanë nga 391 ditë pune.

4. Baza Ligjore

Sipas nenit 35 paragrafi 7 i Kontratës Kolektive nr.2056 e datës 18.04.2017, parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese të të punësuarve për ushqim.”*

Sipas nenit 35 paragrafi 7 i Kontratës Kolektive nr. 105 e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHKU-ut) u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese të të punësuarve për ushqim.”*

5. Vlerësimet përfundimtare të gjykatës

Gjykta, pas administrimit dhe vlerësimit të provave, vlerëson se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë dhe pretendimet e paditësve vërtetohen nga provat e prezentuara me padi, andaj në këtë mënyrë plotësohen kushte ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, për arsye se e paditura ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, mirëpo e njëjta nuk ka paraqitur përgjigjen në padi.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 7 i Kontratës Kolektive nr.2056 e datës 18.04.2017 dhe nenin 35 paragrafi 7 i Kontratës Kolektive nr. 105 e datës 22.01.2021, konstaton se e paditura ka obligim që punëmarrësve të saj që punojnë në institucionet arsimore t'ia kompensoj shumën në lartësi prej 2€, për çdo ditë pune në emër të ushqimit(shujtës). Andaj, në këtë rast gjykata konstaton se paditësve i'u takon kompensimi në lartësi prej 782.00€ për secilin në emër të kompensimit për ushqim(shujtë) për 391 ditë të punës nga data 21.01.2021 e deri me datën 22.11.2022 dhe për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, u vendos komfor nenit 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.300/2023, datë 24.04.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 dite pas marrjës së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.